Contra Spem Spero f.2

Lëvizja për Universitetin - Tiranë f.4

Vetëm 5 minuta, jooo më shuuuumë f.7

Kronika Rosé f.8

Best/worst 2018 f.9

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 03 / JANAR 2019



editorial

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Redaksia dhe bashkëpunëtorët:
Adea Kondirolli
Etnik Jakupi
Indrit Ferati
Zogë Hasani
Valon Dervishaj
Vesel Veseli
Dieta Bytyqi
Basri Oruqaj
Qëndrim Veseli
Dibran Hoxha
Gramos Buçinca
Rron Gjinovci

Dizajni:
Visar Arifaj

Kontakti:
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë

Në këtë numër të tretë, nuk pata tjetër mundësi veçse me ju tërhek vëmendjen me nji titull latinisht. Qëllimisht nuk po e zbuloj në hyrje, e as në fund, ashtu që lexusi me u detyru me lexu këtë editorial në rast se ka kureshtje me gjetë kuptimin e shprehjes. E nëse nuk ka kureshtje, që është nji nga atributet ma të mira që mundet me i pasë nji njeri, atëherë mos ta shfletojë as këtë numër të tretë të gazetës kritike e satirike Tempulli i Dijes. Njerëzit që nuk kanë kureshtje, pra vullnet për të vërtetën, e rrjedhimthi as mendim kritik, veçse nervozohen kur na lexojnë dhe në fakt, nuk arrijnë me e kapë poentën e tanë punës së kolegëve të mi redaktorë e dizajnerit tonë legjendar. Prandej, ai që nuk ka kureshtje le të largohet sepse shtjellimi serioz po vjen.

Ky numër i tretë i Tempullit të Dijes po vjen si nji sukses i ORCA-s dhe redaksive vullnetare që punuan në këta 3 numra. Arritëm me i bindë donatorët që edhe në vitin 2019 me i financu 4 numra të tjerë. Pra, Tempulli i Dijes ka me vazhdu, me të edhe kritika e satira e veçantë e tij. Ashtu siç jemi zotu që në numrin e parë: t'gjitha ato që dihen prej hulumtimeve "serioze" të shoqnisë civile për arsimin e lartë, Tempulli i Dijes po ia bjen publikut me nji gjuhë t'bukur, t'kapshme e të thjeshtë. Sigurisht edhe me humor, aq sa na lejon mjerimi i arsimit me ba humor me të.

Numri i tretë, që shënon edhe mbylljen e vitit 2018, nji viti përplot skandale që shënun ngjarjet e arsimit në Kosovë, të përcjelluna me shpresën që po vjen si fllad qi ngrohë prej Shqipnije, është nji përmbledhje e ngjarjeve që shënun atë vit. Atë e karakterizuan dy shpresa: shpresa jonë për me vendos standard në cilësinë e mësimdhënies në Universitetin e Prishtinës dhe shpresa e atyne me i ikë llupës tonë e cila kapi plot parregullsi a dallavere dhe i çoi ato para çekiçit ndëshkues. Nji shpresë, kundër nji shprese ishte gjith viti 2018.

Shpresa jonë filloi me marrë formë kur Ministri Shyqë, nënshkroi nji udhëzim administrativ, të parin e vitit 2018 dhe të parin e llojit të vet, lidhun me platformat në të cilat duhen me u indeksu revistat shkencore të cilat do të merren parasysh për avancime akademike në Kosovë. Ky qe nji hap i madh, në katrahurën universitare të Kosovës. Mendum se fitorja u arrit, se mendësia e vullneti ynë si ORCA dhe i inspiruesve tanë që kishin punu para neve në këtë fushë, u institucionalizu dhe se mashtrusve u ishin mbyllë tana vrimat. Ani pse na e dijshim, bile edhe ishim paralajmëru prej disa skeptikëve miq tanë se udhëzimi nuk ishte nji zgjidhje e qëndrushme.

Por, nuk e kishim paramendu asnjiherë se i ashtuqujtuni profesor i UP-së është në gjendje me shku aq larg tu shpresu sa ndonji nga supermenat e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Këta legjenda të gjalla, mendun se kishin me na e mshelë gojën tu na i gju për ftyre prej 8 deri në 19 punime "shkencore" të publikume mrena ni viti. Në atë stilin "A punime po doni a? – Punime ju rrasi." Kjo shënoi "mega skandalin" siç kishte me thanë shoku jem Genti, të supermenave të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike. Këta legjenda të gjalla, figurat ma tragji-komike të arsimit në Kosovë, mendun se na lanë pa tekst. Kishin shpresu me gjasë që përmbushja formale e kritereve nga ana e tyne kishte me na lanë neve si qurën në mjegull. Por, Adea, Gramosi e Venera nuk ta falin sekondin. Iu përveshën hulumtimeve dhe zbulun se nji profesor norvegjez i të njajtës fushë arrinte me publiku veç 0.96 punime shkencore në vit. Këte e bazonin në hulumtimin që ishte publiku në nji revistë të mirëfilltë shkencore. E këtu kishte veç dy mundësi: ose profesori norvegjez kenka i mosditun, ose këta tanët s'janë në vijë me etikën akademik. Nuk u mjaftun me kaq kolegët e mi dhe i zhveshën mirë të gjitha të metat e 3-4 revistave ku kishin publiku supermenat. Morën edhe ndihmën e ekspertit global, mikut tonë, Jeffrey Beall, dhe ia përplasën për ftyre supermenave dhe rektoratit faktet e reja.

Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

CONTRA SPEM SPERO

Si gjithnji, në Kosovë respektohen ligjet formale. Ata formalisht i kishin përmbush kriteret dhe me shumicë votash kalun avancimet në Senatin e UP-së.

Por, lufta nuk u krye me kaq. Koleget tona tjera të zyrës ligjore, Fitorja e Fatjeta nën mbikqyrjen e avokates Rina Kika e përgatitën nji super ankesë para Këshillit të Etikës.

Disa muaj ma vonë, mbas presioneve të kohë pas kohshme nga ana jonë, Këshilli i Etikës na përballi me pretendimet qesharake të supermenave të cilat i kishin paraqitë si mbrojtje. E këtu, u njoftova me nji supermen të vërtetë, të cilin e kisha pas afër kaq shumë kohë e s'e kisha pas ditë. Kolegen tonë Adea Kondirolli e cila krye nji jave grumbulloi 492 faqe prova për 38 punimet e "supermenave" të inxhinierisë mekanike duke mos lanë fjali të kopjume për pa e nënvizu, përkthim me gabime (google translate) për pa e nënvizu, kopjim e ndryshim titujsh për pa e nënvizu, e të cilat me shumë krenari ia deponum Këshillit të Etikës i cili po mundohet me i dhanë zgjidhje kontestit "Contra Spem Spero". Shpresa kundër shpresës. Shpresa jonë për drejtësi e meritokraci, kundër shpresës së supermenave fallc, për shmangie nga llupa e supermenit të vërtetë, e pasionit tonë që s'ndalet: për arsim cilësor siç na udhëheq emri i organizatës që na përfaqëson dhe e përfaqësojmë.

Rron Gjinovci



Lëvizja për Universitetin - Tiranë



Durim Jasharaj

Lëvizja për Universitetin është themeluar në vitin 2014 nga një grup i studentëve dhe profesorëve me orientim të majtë. Kjo lëvizje nisi me kundërshtimin ndaj reformës për Arsimin e Lartë, reformë kjo e filluar nga qeveria Berisha e vazhduar më pastaj nga qeveria Rama.

Lëvizja për Universitetin kritikoi ashpër Reformën për Arsimin e Lartë duke gjykuar procesin si jo legjitim dhe përmbajtjen e projektligjit si shkatërrimtarë për universitetet publike.

Kritika dhe kundërshtimet ndaj Reformës

Reforma për Arsimin e lartë u zhvillua prapa shpinës së publikut. Në komisionin e themeluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për hartimin e Reformës, në përbërjen e tij nuk gjeti vend askush nga universitetet publike. Por, në hartimin e saj u kujdes lobi i fuqishëm i universiteteve private të lidhur me politikën dhe mediet për të ndikuar përmbajtjen e ligjit, sidomos pjesën e financimit. Reforma që nga fillimi ishte një proces jo transparent dhe arbitrar. Komisioni për hartimin e Reformës kurrë nuk e solli projektligjin në diskutim publik për studentët dhe stafin akademik. Kështu, qeveria dhe ministria, përmes këtij komisioni dhunoi lirinë akademike dhe autonominë e universiteteve publike duke i shpërfillur ato.

Me anë të kësaj Reforme universiteti u vendos në kontroll qeveritar. Kjo gjë u mundësua nga Bordi i Administrimit si organi më i lartë administrativ i universiteteve publike. Bordi Administrativ do të kishte fuqi vetoje për krejt financimin dhe një pjesë të konsiderueshme të administrimit të jetës universitare publike. Në pothuajse të gjitha universitetet publike, shumicën e këtij bordi do ta përbëjnë përfaqësuesit e qeverisë (raporti 4 me 3 për qeverinë).

Me anë të kësaj Reforme, universitetet private do të financoheshin nga buxheti i shtetit për siç thotë ligji "kërkime shkencore" dhe për "bursat e ekselencës". Kështu, buxheti publik edhe ashtu i varfër e i pamjaftueshëm për nevojat e arsimit të lartë publik do të ndahej edhe me universitetet private. Kjo me automatizëm nënkupton që universitetet publike do të kenë gjithnjë e më pak para. Dhe kur fondet do të pakësohen edhe si rezultat i financimit sipas përformancës, universitetet publike në mënyrë që të sigurojnë ekzistencën do t'i rrisin tarifat për studime në kurriz të studentëve. Konkurrimi midis universiteteve publike dhe atyre private do të prodhojë një situatë ku universitetet më të dobëta do të financohen më pak dhe, për pasojë, do të kenë tarifa më të larta studimi. Këtu gjendet paradoksi i një universiteti të keq dhe të shtrenjtë. Kësisoj qeveria në vend që t'u kërkojë llogari drejtuesve universitarë për cilësinë e studimeve, do t'i shtyjë universitetet publike drejt falimentimit dhe mbylljes.

Pjesëmarrja studentore në vendimmarrjen universitare është një tjetër shqetësim. Sipas Reformës studentët s'do të kishin ndikim vendimmarrës. Përqindja e lejuar (10% e votave në zgjedhjen e dekanëve dhe rektorëve) është jo vetëm e papeshë në raport me të tërën dhe numrin e studentëve, por edhe më e ulët se niveli aktual i të drejtave të tyre zgjedhëse (20%).

Për të kundërshtuar miratimin e reformës e pastaj edhe zbatimin e saj, Lëvizja u angazhua që nga ditët e themelimit. Lëvizja dhe aktivistët e saj shkruan me qindra shkrime, prodhuan dhjetëra analiza e kritika. Organizuam me qindra takime e tubime me studentë. Organizuan peticione, aksione simbolike, bllokime fakultetesh dhe protesta. Lëvizja u angazhuan edhe për luftimin e korrupsionit në universitete duke demaskuar profesorë që shisnin libra e provime. U angazhuan për kushte më të mira jetese në konvikte, kundër ngacmimeve seksuale dhe kundër burokracisë së administratës nëpër fakultete. Lëvizja ishte edhe atje kur protestohej për parkun e liqenit. Ishte edhe aty për të kërkuar drejtësi për Arditin e vrarë në Landfillin e Erion Veliajt. Prandaj, dhjetori i këtij viti nuk është befasi. Është rezultat i angazhimit të palodhur dhe konsistencës për këto katër vite. E kur më së paku e prisnin siç ndodhë zakonisht, plasi revolta e studentëve.

Dhjetor i shpresës – shpërthimi i protestave masive studentore në Tiranë

Protesta e studentëve filluan si reagim kundër një vendimi të qeverisë i njohur atje si "VKM". Ky vendim parashihte që për çdo provim të bartur studentët do të paguanin një shumë të caktuar të hollash. Varësisht prej kredive që kishte lënda, pagesa do të sillej deri në 30 euro për një provim.

Protesta filloi me 4 dhjetor 2018 nga studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës. Protesta nisi para godinave të fakultetit për të vazhduar më pastaj para Ministrisë së Arsimit. Studentët kërkonin anulimin e VKM-së dhe uljen e tarifave për studim. Protesta vazhdoi duke u masivizuar dhe revoltës së studentëve të Arkitekturës ju bashkuan edhe fakultetet tjera me radhë. Që në ditën e tretë të protestës, qeveria në panik anuloi VKM-n. Por, tashmë ishe vonë për të kënaqur studentët. Protesta sa shkon e masivizohet. Asaj i janë bashkuar qytetarë nga shtresa e profesione të ndryshme. Që nga gjimnazistët e deri te pensionistët. Protestat kanë filluar edhe në qytete të tjera universitare. Protesta ka shtruar tetë kërkesa për të cilat nuk pranon kompromis e as negocim. Për to do të protestohet deri në realizimin e tyre.

Kërkesat e tyre janë:

1. **Shfuqizimin e ligjit të arsimit të lartë, si pikënisjen nga ku do mund të rinisë reformimi i vërtetë i jetës universitare, bazuar në lumin e kërkesave të artikuluara nga masa studentore.**
2. **Dyfishimin e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë. Nëpërmjet tij do të siguroheshin: përmirësimi i kushteve të jetesës në konvikte, pasurimi i bibliotekave, zhvillimi i kërkimit shkencor, zgjerimi i mjediseve universitare dhe i stafit akademik etj. etj... lista është e gjatë.**
3. **Arsim publik falas në të gjitha nivelet si themel i studimit sipas meritës.**
4. **Reformimin e vërtetë të jetës universitare mbi bazën e parimeve të demokracisë brenda universitare: krijim i një asambleje universitarësh, të zgjedhur me votë të barabartë studentësh dhe pedagogësh në çdo fakultet universitetesh publike.**

Përkundër sulmeve dhe obstruksioneve qeveria dhe partitë opozitare përmes forumeve rinore dhe këshilleve të studentëve, studentët bashkë me Lëvizjen për Universitetin po shënojnë fitore ndaj propagandës anti-protestë.

Protesta vazhdon përmes bojkotit.

FAQE 5

PERLA TË UP-SË

Përshkrim i punëve që i ka kry nji profesor

NO COMMENT (Nga nji CV e UP-së)

Data:	Tetor 2008
Vendi:	Prishtinë
Emri i Institucionit:	Fakulteti i shkencave sportive
Pozita:	Profesor Asistent I lëndve: Anatomi funksionale dhe Mjekësi sportive
Përshkrimi:	I kam mbajtur ligjeratat,u kam spjegu ua kam skjaru krejt çka kanë pasur të pakjartë,i kam mbajtur provimet,ua kam qit rezultatet dhe ua kam tregu testet se ku kanë gabuar. Poashtu çdo javë kam mbajtur konsultime.

Dikush ka aftësi o daj, t'kqyr n'birë t'synit edhe t'bindë

Të gjithë e dimë se ka lloje të ndryshme të njerezve: i mirë, i keq, romantik, liberal, që bohet nervoz shpejt etj. Për t'komuniku me ta është sfidë e madhe si zyrtar. Ajo kërkon sakrifica, njëra ndër to është msimi i drejtshkrimit. Shpresojmë se do të na vetë-motivoj edhe neve si shoqëri. (Nga nji CV e UP-së)

AFTESISTE E KOMUNIKIMIT	Të folurit në mënyrë adekuate me një shumëllojshmëri të njrëzve, ndërsa duke mbajtur kontakt me sy, demondtrimi i një vokabulari të pasur dhe përshtatja e gjuhës me audiencën, dëgjimi në mënyrë efektive, tëshkruarit në mënyrë të qartë dhe koncize dhe të punuarit mire në grupe, përdorimi i mediumit të duhur, dhënja dhe marrja e feedbackut, etj.
AFTESISTE ORGANIZATIVE/ MENAXHERIALE	Sensi i organizmimit, përmbajtja e orarit dhe afatit të punës, nivel të lartë të përqendrimit dhe aftësi të shkelqyera organizative, aftësi për të punuar në më shumë se një project në të njejtën kohë, madje edhe në mjedise me presion të lartë të punës, sense të mire në përcaktimin e prioriteteve
AFTESITE E PUNES	Konfident, i motivuar, shpirt-ekipor, aftësi për t'u përshtatur në mjedise multi-kulturore, aftësi të mira komunikimi, objektivisht kritik dhe vetë-motivues, qendrim pozitiv ndaj planeve të ardhshme

Multi-funksionaliteti si esencë

Komandat, gjeneral, sekretar shteti, anëtar bordi, prodekan, prorektor...
(Nga nji CV e UP-së)

Shkathtesite e komunikimit	Të fituara si Zv. drejtor I Administratës Tatimore të Kosovës, Kryesues i Departamentit të Auditimit të KRRPP të Kosovës, Anëtar dhe kryetar I Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Prodekan për financa në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, Prorektor për Buxhet e Financa në Universitetin e Prishtinës, dhe funksione e detyra tjera me përgjegjësi publike e profesionale si dhe si mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës.

Google translate, ç'na e qite gazin (Nga CV e Ajvaz Berishës në gjuhë angleze)

Who sad that tigers is an dangerous animal. He can liberating fatherland. He has colour orange and is fast and beautiful.

tiger tiger? jes papa? did you ever read a bok? no papa! are you llajn? no papa!

In beginning of war in Kosovo , voluntary joined the his Comrade-in-arms of KLO for liberation of fatherland . Hi was a leader of special unit „ Tigers" part of Headquarter of KLO. There is published bok „ Dialogue with co mandate Tiger"- Ajvaz Berisha.

Disavantazhet kryesore të saj mund të jenë [illegible] vazhdueshëm (pasi gjatë një pjese të kohës së punës mund të mos jet[illegible] të pranishëm menaxherët), vështirësitë që ekzistojnë në zgjedhjen [illegible] problemeve të ndërlikuara (për shembull disa punonjës m[illegible] [illegible] të mos jenë disponibil gjatë [illegible] cilat kërkojnë mendimin e specialistëve).

Ndarja e punës. Ka të bëjë me dy apo më shumë persona, të cilë[illegible] kryejnë të njëjtën punë. Njëri prej tyre mund të punojë në mëngjes dhe tjetri pasdite, apo një ditë njëri e një ditë tjetri. Kjo zakonisht preferohet nga familjarët, të cilët përkujdesen për fëmijtë, pra gratë në veçanti e parapëlqejnë ndarjen e punës, sepse kjo i lejon që të merren edhe me punët e shtëpisë dhe të kenë mundësi të punësohen.

Kur je gati tu e bo punimin e katërt shkencor brenda natës, se ORCA ka dalë me raport të ri edhe nuk din çka me shkru n'fund del seksist.

Profesorat po ankohen se ORCA po e demotivon punën e tyre akademike dhe kanë bërë kërkesë që publikimet e tjera të kenë datë, që herën tjetër të përgaditen më shumë.



Vendimi i Ministrisë: Shkollat një orë mësim për miqësinë e Kosovës me ShBA-në

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka marrë vendim përmes të cilit u kërkohet të gjitha institucioneve të arsimit parauniversitar që të mërkurën orën e parë të mësimit t'ia kushtojnë miqës

kallxo.com

Mënyra e vetme me e promovu Kosovo*-n është me i ndihmu një shteti në lufte dhe pas disa vitesh, fëmijët e atij shteti të mbajnë trajnime për besën dhe mikpritjen. Trajnerët kosovarë që kanë mbajt trajnime për trajnime, mund të trajnojnë trajnerët që do të trajnojnë femijët në trajnimin për Kosovo*-n. Imperializmi nuk t'vet.

KRONIKA E ZEZË



Rasti i Milaim Sejdinit

VETËM 5 MINUTA, JOOOO MË SHUUUUUUMË

Studentë të Universitetit të Prishtinës, të përkrahur nga Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), kanë protestuar në oborrin e rektoratit për të kundërshtuar avancimin e një profesori i cili dyshohet për disa shkelje të rënda disiplinore.

Ndaj këtij profesori u adresuan tri akuza secila më e tmerrshme se tjetra: për plagjiaturë, për falsifikim dhe për ngacmim seksual ndaj një studenteje specializante.

Ky profesor, duke i kërku favore seksuale është akuzu se i ka thonë studentes që "kjo punë zgat veç 5 minuta".

Profesori nuk u avancu.

"Askujt s'i lejohet me u ofendu prej të vërtetës" —Aristoteli

Vendimi i gjykatësit Adnan Konushevci të Gjykatës Themelore ia ka ndalu nga qarkullimi organizatës Admovere pjesën e raportit që flet për plagjiaturën e Mejdi Bektashit, profesor në Fakultetin Juridik, e cila i referohet një artikulli të Gazetës Express të vitit 2007.

Si qenka e mundur që të censurohet një raport në emër të një padije për shpifje, ndonëse raporti bazohet në një artikull publik, në një artikull që asnjëherë asnjë institucion nuk e ka cilësuar si shpifje.

Drejtori i ORCA-s, Rron Gjinovci, i cili nuk priton me hi llugave, për inati ka dalë e ka lexu artikullin në oborr të Fakultetit Juridik sepse, siç tha ai:

"Askush nuk do ta cenojë fjalën e lirë. As një profesor, as një politikan, as një gjykatës, sepse fjala e lirë është themel i shoqërisë sonë, i kulturës evropiane të cilës i përkasim dhe liri e pacenueshme. Është nga ato liritë dhe të drejtat për të cilat ia vlen të vdesësh."



Dosja FIM

Mbas ankesës së ORCA-s në Këshill të Etikës së Universitetit të Prishtinës për Supermenat e FIM-it, këta profesorë kanë thonë që punimet e tyne e kanë përmirësu cilësinë e Universitetit, dhe rangimin e tij.

E për me ju tregu atyne që s'e kanë bash mirë, ORCA ka dorëzu 492 faqe prova. Këto prova përfshijnë: 38 punime të vjedhme prej profesorëve nga punimet e tyne, e t'tjerve. Këto 38 punime përmbajnë plagjiaturë – kopjim pa citim apo referencim, gabime drejtshkrimore e gramatikore, si dhe paraqitje të të njejtës përmbajtje me dy tituj si dy punime të ndryshme.

Shpresojmë që kjo është hera e fundit që shkrujmë për Supermenat e Inxhinierisë Mekanike, se edhe na jena lodhë.

27 veta për nji marrëveshje

Një vizitë është realizuar më 14 dhjetor 2018 në Universitetin Teknik Yildiz të Stambollit. "Me ftesën e universitetit nikoqir nga UP-ja në këtë vizitë kanë marrë pjesë 27 persona, pjesëtarë të Këshillit Drejtues, të menaxhmentit dhe senatorë të UP-së. Shpenzimet e akomodimit për realizimin e kësaj vizite janë mbuluar nga Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim – TIKA, ndërsa shpenzimet e ushqimit janë mbuluar nga universiteti nikoqir dhe partnerët tjerë nga Turqia" është thënë nga zyrtarë në zyrën e rektorit Marjan Dema. Megjithatë, është turp me shku 27 veta për nji marrëveshje. Turp prej nikoqirëve.

Kronika Rosé



Estrada e UP-së po ashtu ka probleme serioze me plagjiaturë dhe integritet akademik.

Dyshja fantastike e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

E këtu fjala është për dyshen fantastike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike **Luan Ahma** e **Sabri Limari** të cilët përkthejnë pjesë të përzgjedhura nga libri i një autori kroat «Prijenos elektricne energije» dhe i botojnë me emrat e vet. Madje këta s'e kanë pa të arsyeshme me u lodh as për ilustrimet e grafikat e librit. Ahma ishte treguar mjaft rigoroz ndaj plagjiaturave te profave tjerë por te vetja ëëëëëë… Ai vazhdon të jetë profesor në nivelin Master në FIEK.

RAPORTUAR NGA: ADMOVERE.ORG

Kadri Metaj talenti i Filozofikut

Profesori Metaj është akuzuar se doktoratura e tij e publikuar në vitin 1989 është plagjiat kryesisht nga vepra e Frederic Jameson dhe ajo e Stefan Moravskit. Në një reagim të Metajt ai i cilëson akuzat për plagjiat shpifje dhe shton se punën e tij mund ta gjykojnë vetëm ata që janë ekspertë (siç duket profesori kërkon ekspertë të plagjiaturave). Kadri Metaj jo që nuk u ndëshkua por madje edhe u avancua. Neve s'na mbetet gjë tjetër pos t'i urojmë avancim të mëtutjeshëm!
(me rëndësi shneta).



Shaolin Gang thyejnë integritetin rozë ne stilin "sku skuuu"

Më të stërpiktit e estradës sonë Shaolin Gang krejt pa dashje kanë kopjuar këngën e tyre "Shaolin Gang" nga reperi amerikan The Ransom. Ndoshta Shaolinat këtë këngë e kanë publikuar vetëm për planetin "Namek" por ja që ne si redaksi me aftësi të larta hulumtuese kemi arrit me kuptu që kënga është publiku edhe në Tokë (Tululu o plagjiatura). Sido që të jetë ju Shaolina mos ndaloni stërpikjen e estradës. (Ju jeni shtekerat e kësaj pune).



Mona Enca & Mona Nicki

Këtë herë fjala është për akuzën e Encës ndaj Nicki Minaj-it e cila pretendon që reperja amerikane i ka vjedhur idenë e kreativitetit të jashtëzakonshëm të Encës, që veten ta vendos në pikturën e Van Gogh, e të njëjtën gjë e ka bërë Nicki në një pikturë tjetër por që Enca nga syri i saj tejet analitik e ka parë si një kopjim të kulluar. Por ne e dimë të gjithë që Mona Enca është një hap para të gjithëve. E ky "kopjim" mund të vërehet edhe nga një sy mesatar Kosovar.

Rina Balaj - "Mami" probleme me integritetin rozë?

Përkundër që redaksia jonë është e pajtimit që Rina është "Mami" (se mos pi bina msysh) e estradës sonë të suksesshme, titulli i saj po vihet në "?". "The amazing Rina" siç duket nuk ka mundur t'i ikë trendeve të plagjiaturës duke e kopjuar këngën "Fly" nga Slatkaristika. E neve nuk na mbetet kurgjo me thonë ma shumë veçse: ti po din ti grahi, ti prapë mbetesh "Mami".

REKTORI

Në janar të vitit 2018 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lëshoi udhëzimin administrativ 1/2018 që precision revistat me recension ndërkombëtar të … për publikim. Ky udhëzim është një hap i rëndësishëm sa i përket ndalimit të publikimeve në revista të dyshimta dhe avancimeve jomeritore.

JANAR 2018

ORCA lansoi kampanjën e dhurimit të librave për bibliotekën e konvikteve. Gjithsej janë dhuruar 500 libra dhe 2000 publikime. Mes donatorëve kishte organizata jo qeveritare, shtëpi botuese, personalitete te shquara, etj.

14 SHKURT 2018

Shkarkohet prorektorja Teuta Pustina. Me vendim të këshillit drejtues të UP-së, pas presionit disa ditor nga përfaqësues studentor, organizata jo qeveritare, shoqëri civile dhe studentë të UP-së, është shkarkuar prorektorja Teuta Pustina pas deklaratave seksiste nga ana e saj.

29 MARS 2018

Inspektorati anulon rregulloren për avancime në Fakultetin e Arteve. Nëse do të votohej kjo rregullore do të cenonte drejtpërdrejt cilësinë e mësimdhënies duke e shpërfillur ekzistencën e gradës "Doktor i Arteve", duke e njohur vetëm gradën "Master i Arteve", kësisoj duke pamundësuar konkurrencën e doktorëve të arteve dhe doktorantëve të arteve në këtë fakultet.

KORRIK 2018

Dorëhiqet prorektori Naser Sahiti pasi luajti një rol negativ në rastin e avancimeve të profesorëve "Supermenë". Ai kishte deklaruar: "Ne nuk mund ta dimë si janë ba ato punime, nëse kandidatët e caktuar kanë punu me vite dhe të themi pastaj janë ulë, i kanë shkru, i kanë botu" duke tentuar që të relativizojë diçka që në publik është quajtur shkelje e integritetit.

SHTATOR 2018

REKTORI

Përjashtimi nga 'EQAR' i Agjencisë Kosovare për Akreditim për shkak të shkeljes së standardit të pavarësisë institucionale. Kjo ka ndodhur për shkak të vendimit që është marrë nga Kryeministri i Kosovës për shkarkimin e anëtarëve të Bordit dhe të menaxhmentit të Agjencisë së Akreditimit.

SHKURT 2018

Vazhdon gjuha seksiste në UP. Për këtë kësaj radhe përkujdeset prorektorja Teuta Pustina me deklaratat e saj seksiste. Në fakt prorektorja përmes deklaratës së saj ka fajësuar viktimat e sulmeve dhe ngacmimeve seksuale, duke aluduar se fajin e ka veshja e viktimave.

MARS 2018

Avancohen "Supermenët" e Fakultetit të Inxhinierisë mekanike
- Ahmet Shala
  (18 punime në një vit e gjysmë)
- Azem Kycyku
  (12 punime në një vit e gjysmë)
- Mirlind Bruci (10 punime në një vit)
- Naser Lajqi
  (10 punime në një vit e gjysmë)
- Nexhat Qehaja
  (9 punime në një vit e gjysmë)
- Ramë Likaj
  (19 punime në një vit e gjysmë)
- Rexhep Selimaj
  (7 punime në një vit e gjysmë)
- Xhevat Berisha
  (15 punime në një vit e gjysmë)

SHTATOR 2018

59% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt e vet akademik thuhet në konferencën që e organizoi ORCA me titull "Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe menaxhimi në Universitetin e Prishtinës"

29 TETOR 2018

Rasti i Mejdi Bektashit – shih kronikën e zezë

NËNTOR 2018

Rasti i Milaim Sejdinit – shih kronikën e zezë

NËNTOR 2018

rrugës së atrofizimit trunor

ku mbarë botën bëhet atrofizimi i trunit sa i përket imagjinatës, e më pas shndërrohet në nji tru të aftë të kryej nji funksion si nji makinë e programuar, e cila ndjekë algoritme, e duke ndjekë shabllone ai shuhet. e up-ja hala ma keq se t'len sakat, se imagjinatën ta bon shoshë, po edhe shabllone nuk t'mson.

eh qeto sene m'vin n'men kur po ulna po rahatona, e po duhet me prish rahatinë e mu drejtu se erdh "profi". mos m'pengo kur jam tu spjegu, e kur ta kry fjalën un, e ti e harron pytjen tani m'vet; me pas dit ti qeto qe po i spjegoj e mos me pyt sene jashtë libre e kishe marr semestrin e kalum 8she, po i ki marr 6she; he? edhe sa provime t'metën për prill. (menoj nji bisedë imagjinare me profen).

ky osht laboratori, me qesi laboratore ka punu galileu edhe njutoni, ky është nivel shumë i lartë i laboratoreve në kosovë. nejse n'botë po punojnë me intelegjencë artificiale, po ma mirë me menu me tru na, se truni ma i mirë se me kompjuteri ashtu-kshtu.

me bo me i vet pse kem windofs xp hala (s'po bon se mos po u vjen rand) po nejse edhe golf 4 është ma i mirë se golf 5, nashti edhe windofsat qat logjik e kanë. krejt qa m'bjen n'mend është se moda e veshjeve klasike është shumë ma e mirë se ktyne moderne, e flen me mendimin se nashti edhe teknologjia e avancimet e tyne sa ma klasike ma t'mira.

me ni anë biciklla ma e mirë se kerret, kur ki me ec ni kilometër normal, për distanca t'vogla. bile t'bon ma t'shnetshëm, e mu kon shnosh me randsi, s'ka lidhje pse s'munesh me mrri me udhtu boten e mistereve.

Etnik Jakupi,
student i Fakultetit të Shkencave Matematiko – Natyrore

Rregullorja e Universitetit të Prishtinës

1. Respektimi i orarit

Nëse ligjërata fillon në ora 10:00, studenti duhet t'jetë prezent në sallë minimumi në ora 9:55. Ndërsa profesori mund t'jetë i pranishëm në 10:45, dhe të fillojë evidentimin e studentëve, që të ndëshkohet studenti që s'pat durim me prit 45 minuta.

2. Kohëzgjatja e ligjëratës

Ligjërata duhet t'zgjat 1 orë e 30 minuta. Profesori duhet të ligjërojë gjatë gjithë kësaj kohe, që është presion i madh për ta. Jo se profesori është i paaftë në profesionin e tij, po është e pamundun me folë 90 minuta për një temë të caktume. Prandaj, profesorit i lejohet me folë për anëtarët e familjes, dhe përvojat e tyne jashtë vendit, që janë shumë të dobishme për studentët.

3. Obligimi moral i studentit

Studenti ndihet i obliguar moralisht që të nënshkruajë listat e mbajtjes së ligjëratave (2-3 lista në një ligjëratë).

4. Kohëzgjatja e provimit

Provimi në fund të semestrit, duhet të zgjatë 1 orë e 30 minuta.

5. Konsultimet

Zakonisht konsultimet nuk mbahen, vetëm në ndonjë rast të veçantë kur profesori kërkon, mirëpo edhe atëherë të drejtë për konsultime kanë vetëm vajzat, sepse te ato mund të ketë bërë profesori ndonjë gabim.

6. Përfundimi i vitit akademik

Një vit akademik mund të zgjat 1 deri në 2 vite, por në universitetin tonë mund të kesh ekstra ofertë nga profesori që një vit akademik ta përfundosh për 5 minuta.

7. Literatura

Studenti është i obliguar që të blejë literaturën e profesorit. Pasi që ai është profesori i lëndës dhe me mundin më të madh do të gjej material nga librat tjerë dhe do përkthej e përshtat për studentët. Nuk e di a do mund të ngritemi ndonjëherë në lartësinë e sakrificës së tyre!

8. Raporti student profesor

Studenti duhet të i përshtatet disponimit të profesorit. Nëse profesori është pa disponim (nervoz) studenti nuk duhet ta mundojë profesorin me pyetje të njëpasnjëshme.

9. Mjetet ndihmëse për kontrollimin e provimit

Për shkak të numrit të madh të studentëve, dhe numrit të vogël të profesorëve ata janë shumë të ngarkuar me kontrollimin e tyre, dhe ju lejohen mjetet ndihmëse si:

1. Kompas
2. Vizore
3. Dhe ndonjë mënyrë tjetër kreative e tyre.

Lusim studentët të ju përmbahen rregullave të Universitetit.
"Urdhri nuk diskutohet por vetëm zbatohet" Enver Hoxha

Zogë Hasani,
studente e Fakultetit të Arteve

Fillimisht, me që nuk është fletë e mesit, kjo fletë nuk mund të çkoqet por duhet të çkyhet përgjatë vijave të ndërprera.

Fletën e çkyer duhet ta ndrydhni përgjatë vijave të kuqe të vizatuara në të në mënyrë që ta fitojmë fitilin. Kjo lëvizje bëhet intuitivisht me përdredhje manuale.

Pasi t'ia keni marrë doren kësaj flete, nëse keni nevojë për më shumë fletë në këtë dimër të ftohtë, mund t'i përdorni edhe faqet tjera të Tempullit të Dijes për kallje të shporetit.

KUJDES: Mos t'ju ndodhë ta djegni faqen 2, ku ndodhet emblema e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Djegia e këtij simboli është shpallje lufte ndaj miqëve dhe aleatëve tanë.

Gjatë kalljes së shporetit, në momentin e ndezjes së kësaj flete, mund ta mendosh një dëshirë. Kjo nuk do t'thotë se do të plotësohet. Redaksia e TD nuk mban asnjë përgjegjësi në rast dëshprimi.

Zjarri nuk është lojë.

kjo faqe është për me e kallë shporetin

Contra Spem Spero f.2

Lëvizja për
Universitetin - Tiranë f.4

Vetëm 5 minuta,
jooo më shuuuumë f.7

Kronika Rosé f.8

Best/worst 2018 f.9

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 03 / JANAR 2019





